



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
DHOMA E DYTE E GJYKATES KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2024:105428

Datë: 25.04.2024

Numri i dokumentit: 05621540

K.DH.SH.II.nr.504/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhoma e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Ramush Bardiqi, ne çështjen juridike përmbarimore të kreditorit Karposan Zimpara Tasi Sanayi me seli ne Stamboll, Republika e Turqisë te cilin e përfaqëson Xhevdet Rama avokat nga Prishtina, ndaj debitorit NPT M... BI me NUI 810594384 me seli rr. Erdit Durham nr. 259 ne Prizren, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e Debitorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale e Kosovës Dhomat e Shkalles se pare- Departamenti për çështje Ekonomike, KPPP.nr.921/23 i dt.30.11.2023, me datën 24.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa e debitorit NPT M... BI me NUI 810594384 me seli rr. Erdit Durham nr. 259 ne Prizren, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale e Kosovës Dhomat e Shkalles se pare- Departamenti për çështje Ekonomike, KPPP.nr.921/23 i dt.23.04.2024, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale e Kosovës Dhomat e Shkalles se pare- Departamenti për çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar, e ka Refuzuar si te pa bazuar prapësimin e debitorit, te ushtruar kundër urdhrin përmbarimor P.nr.237/23 dt. 24.05.2023 i lejuar nga zyra përmbarimore e Përmbaruesit Privat, me te cilin është caktuar përmbarimi sipas propozimit te kreditorit për 3774€, me kamat ligjore prej 8% duke filluar nga dt.21.07. 2021 deri ne pagesën definitive dhe si dhe shpenzimet te procedurës ne vlere prej 424€.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë debitori, për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës përmbarimore, vërtetimit te gabuar dhe jo te plotë te gjendjes faktike dhe shkeljes se dispozitave procedurale, me propozim që gjykata e shkalles se dytë ta aprovoj ne tërësi si te bazuar ankesën e debitorit.

Dhoma e Shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore (LPP), gjeti se:

-Ankesa e kreditorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditorit, ka paraqitur propozim për përmbartim në bazë të dokumentit përmbartimor – aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike II.EK nr. 657/18 dt. 21.07.2021, më gjerësisht si në dokumentin përmbartimor, me të cilin është caktuar përmbartimi nga Përmbartuesi Privat sipas propozimit të kreditorit për 3774 euro, me kamat ligjore prej 8% prej dt.21.07.2021 deri në pagesën definitive si dhe dhe shpenzime të procedurës 424euro.

Dhoma e Shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale vlerëson se gjykata e shkallës së parë në bazë të provave të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendimin e saj të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, prandaj konkludimin e gjykatës së shkallës së parë, lidhur me këtë çështje e pranon edhe kjo Gjykate, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të LPK nga neni 182 paragrafi 2 pika b), g), j) k) dhe m) dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare, në bazë të nenit 194 të LPK-së. Në lidhje me këtë, gjykata e shkallës së parë ka konstatuar drejt faktin se a aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Ekonomike IV.EK nr. 657/18 dt. 21.07.2021, në bazë të cilit gjykata ka caktuar përmbartimin, është dokument përmbartues dhe se kjo parashihet në nenin 22 par.1 pika 1.1 të LPP, ku ceket se “dokument përmbartues është edhe vendimi përmbartues i gjykatës...”, çka paraqet bazën juridike për caktimin e përmbartimit sipas nenit 21 duke i plotësuar kushtet nga neni 24 par.1 dhe 27 par.1 të këtij ligji sipas të cilit “dokumenti përmbartimor është i përshtatshëm për përmbartim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”, andaj pretendimet ankimore të debitorës se ka shkelje të dispozitave ligjore me rastin e lejimit të përmbartimit, sipas vlerësimit të kësaj Gjykatë, nuk qëndrojnë. Duke e shqyrtuar aktvendimin e ankimuar në raport me të gjitha pretendimet ankimore, gjykata ka gjetur se të njëjtat janë të pabazuara. Me nenin 71 të LPP, janë paraparë shkaqet të cilat kundërshtimin e paraqitur ndaj aktvendimit për lejimin e përmbartimit do ta bënin të bazuar, andaj duke pasur parasysh se në rastin konkret nuk ekziston asnjë nga arsyet e parapara në nenet e lartcekura, gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur e ka refuzuar prapësimin e debitorës si të pabazuar. Gjykata me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi. Kompetenca e Dhomës së Shkallës së Dytë të gjykatës komerciale për të vendosur nga ana e gjyqtari individual në shkallë

të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par. 2 të LPP, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë, në procedurën përmbarimore, vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Prandaj, në situatën konkrete të gjitha pretendimet ankimore të debitorës Gjykata i konsideron të pa bazuara dhe të pa qëndrueshme nga se nuk kanë bazë në prova konkrete. Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 209 par. 1 pika b) të LPK-së, lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS,
Dhoma e Shkalles se Dytë
K.DH.SH.II nr.504//24, me datë 24.04.2024

Gjyqtari,
Ramush Bardiqi